



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12-06064-17535 dt. 02.06 2020

Mbledhja urgjente e
Kuvendi Komunal
25.03.2020

PROCESVERBAL

I mbledhjes urgjente të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 25.03.2020

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes urgjente të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19.

Prezent gjatë mbledhjes urgjente të datës 25 /03/ 2020 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nënkryetari Nazmi Hasi, kryesuesi Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, si dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse si dhe asamblistët e Kuvendit Komunal.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj.

Kryetari i komunës z. Ramiz Lladrovci- ne e kemi thirr këtë mbledhje urgjente, dhe kjo mbledhje vjen pas vendimit të MAPL-së që t'i jap vlerësim ligjor mjeteve të cilat do të ndahen për situata emergjente, ky vendim ka ardh si rezultat i shkresave tona kryesisht shkresave nga Komuna e Drenasit. Së pari ju njoftoj për situatën emergjente në komunën tonë, me 11 Mars Qeveria Kosovës ka marrë vendim si rezultat i pandemisë në gjithë botën me i mbyllë shkollat dhe me ndal transportin urban, prej datës 11 Mars e deri sot kur po flasim çdo vendim të Qeverisë së Kosovës e kemi zbatuar në përpikëri, e kam formuar shtabin emergjent komunal, dhe me vonë e kam rrit shtabin me përfaqësues të kompanive të ujësjellësit , pastrimit dhe të zjarrefiksëve sepse është ndi nevoja të kemi një shtab emergjent bashkërisht, ne kemi mbajtur disa mbledhje të shtabit emergjent dhe kemi mbajtur dhjetë mbledhje të bordit drejtoreshë ku kemi analizuar shqyrtuar dhe kemi marrë masa lidhur me situatën në komunën tonë. Ju falënderoj ju si asamblist që keni paraqitur gatishmëri për të kontribuar në këtë situatë të pandemisë në vendin tonë, unë i falënderoj edhe gjithë ata punëtor shëndetësor të cilët po e kryejnë punën e tyre, stacionin policor , drejtorinë e inspeksionit, drejtorinë e shëndetësisë, drejtorinë e shërbimeve emergjente , dhe të gjithë drejtorët i falënderoj për angazhimin e tyre. Ne kemi marrë deri më tani 160 maska, i kemi marrë 180 veshje që janë shumë pak, 60 parë syze mbrojtëse, 2400 doreza, 1000 maska të thjeshta deri më tani që janë shumë pak. I kemi pas 120 raste të ekzaminimit deri më tani dhe nuk kemi pas asnjë rast pozitiv, 94 raste i kemi momentalisht në vetizolim. Gjitha vendimet e ministrisë i kemi zbatuar duke përfshirë edhe orën policore, ne për arsye se kemi marrë shumë pak ndihma dhe nuk dëshirojmë ta rrezikojmë më qytetarin tonë t'i rrezikojmë punëtorët shëndetësor t'i rrezikojmë punëtorët e shëndetësisë, t'i rrezikojmë punëtorët e inspektoratit, të emergjencës, zjarrfikësit të cilët janë përballë vetëm nga data 16 deri më 23 deri më 20 zjarre, inspeksioni po e kryen punën në mënyrën më të mirë të mundshme dhe nuk mund të themi që nuk ka pas ngritje të çmimeve, aty ku ka pas ngritje të çmimeve i kemi informuar, kisha kërkuar përmes juve të gjithë qytetareve që të bëjnë kërkesat e tyre apo ankesat e tyre . Sa i përket arsimit ne kemi filluar me zbatu vendimin e qeverisë për shkollën fillore dhe në dy shkollat teknike e kemi filluar mësimin online që nga dita e hënë me platformat të cilat i kanë siguruar. Ne kemi propozuar një buxhet i cili besojmë në një afat tre muaj mund të jetë i mjaftueshëm dhe sipas ligjit kemi drejt 5 % të investimeve kapitale me i nda në një programi cili e kemi dërguar programin në drejtorinë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në programin 73 mijë e 10 kështu që kërkoj që këtë buxhet i cili ka me u përdor për emergjencë shëndetësore dhe për nevojat tjera që kanë me pas nevojë qytetarët tanë në komunën tonë ta votojnë. Por para se ta votojnë ligji ma jep të drejtën që unë si kryetar i komunës t'i negocioj marrëveshjet ose kontratat me operator por unë kam vendos që t'ia delegoj këtë të drejtë tre asamblistëve dhe dy zyrtarëve të komunës së Drenasit që ata çdo kërkesë që do të bëhet nga shtabi emergjent i

komunës për nevojat e qytetareve ta vlerëson ta shqyrton ta negocion dhe në fund me na dhanë rekomandimin për me e nënshkrua atë marrëveshje kjo është për arsye të transparencës të parasë publike. Unë propozoj kuvendit që dy asamblistë të jenë nga opozita ose 4 asamblistë nga opozita , që dy me i pas rezervë që ne me i pas të mundshëm gjithmonë të gatshëm dhe 2 nga pozita që me qenë të gatshëm në çdo moment në këtë situatë të pandemisë covid 19

Petrit Gashi- I nderuar Kryetar i Komunës së Drenasit, te nderuar drejtor dhe drejtoresha,

të nderuar kolege dhe kolege nga asambleja,të nderuar dhe shumë të respektuar qytetarë të vendit tim,

Jemi mbledhur në këtë Seancë Emergjente në lidhje me pandeminë COVID 19 që ka përfshirë edhe vendin tona, për të dëshmuar dhe për të garantuar që në do të qëndrojmë afër çdo qytetari dhe për qytetarin. Komuna e Drenasit edhe pse ende zyrtarisht nuk ka të infektuar, nuk është immune dhe ne duhet të jemi të përgatitur me të gjitha masat e nevojshme. Kosova në përgjithësi dhe Drenasi në veçanti janë duke e kaluar një kohë jo të mirë në një përballje me një armik të padukshëm por që ka sjell frike e panik tek qytetaret. Mungesat e shumta të familjeve me gjendje sociale, të shëndetësisë por edhe të atyre që kanë nevoja shëndetësorë është me e rëndësishëm se kurrë që ti ndihmojmë në këtë moment.

Natyrisht që ndihma nuk mund të behet nga një njëri i vetëm në këso raste qoftë ai edhe kryetar, por duhet mobilizim i të gjithëve pa dallim partie e gjinie. Sot, duhet të jemi me të bashkuar se kurrë, me të përgatitur se kurrë, dhe më të vendosur se kurrë që të jemi përkrah qytetareve dhe për qytetarin. Prandaj në këtë radhe nuk mundem pa e falënderuar kryetarin për bashkëpunim e Shtabin Emergjent për menaxhim të kësaj sate.

Në gjendje të tilla kur frika, paniku, nevoja e kërkesa për shëndetin është me e madhe se kurrë, qytetarit nuk i intereson a jemi pozitivë apo opozitivë, të pasur apo të varfër, djem apo vajza, burra apo gra por kërkon dorën e shtetit që ta ndjeje afër për nevojat e tyre. Këtë si Drenas ashtu si në të gjitha kohërat duhet ta japim si dëshmi.

I nderuari kryetar,

Të nderuar asamblistë të Kuvendit Komunal në Drenas, Me shumë së 70 % e punëtorëve nga komuna jonë kanë qenë punëtor në sektorin privat apo të vetëpunësuar. Disa qindra familje janë më asistence sociale, ka të tjerë që kanë nevojë edhe për gjerat me elementare për jetë, andaj brenda ligjit dhe me mundësisë tona duhet të bëjmë diçka për ta. E di, se jeta vazhdon edhe pas tejkalimit të kësaj sate, por kisha propozuar që të reduktohen investimet kapitale, të shkurohen shpenzimet në drejtori dhe ti jepet vendim çfarëdo mundësie vetëm e vete që ti ndihmojmë familjet në nevojë. E mirëpresim propozimin prej 229.200 euro por mendojmë së është pak andaj Shuma në të cilën propozojmë ne është 350 mijë euro. Sot si gjithë bota jemi në një sfidë të vështirë, por që ka zgjidhje, dhe zgjidhja me e mire është QËRIMIN jonë në shtëpi. Sot me shumë se kurrë kemi nevojë të bashkohemi për të ndihmuar që sa me lehtë të dalim nga kjo situatë, sot kemi nevojë të shkrimë inatet dhe të punojmë se bashku, sot kemi nevojë që të rrimë afër njeri tjetrit dhe të zgjasim dorën për ndihmë, sot kemi nevojë që qytetarin ta mbajmë të informuar dhe ti japim shpresë, andaj sot Asambleja komunale në Drenas duhet të quhet **ASAMBLEJA E SHPËTIMIT PËR QYTETARET.**

Në mundësitë tona, ashtu si përherë kemi ditur ti rrimë afër njëri-tjetrit sot kemi nevojë edhe për durim, prandaj qytetareve ju themi se Pa Panik, me Durim dhe me shumë kujdes së bashku do e kalojmë këtë

gjendje. Personalisht, dhe ne emër të Iniciativës Qytetare për Drenasin jam në mbështetje të çdo politike buxhetore për të ndihmuar qytetet tonë. Pra ditë më parë isha edhe në zyrë të kryetarit për tu informuar dhe ofruar bashkëpunim, dhe në ditët në vijim se bashku të gjithë do të mundohemi që të tejkalojmë këtë gjendje.

Falënderim secilit prej jush që në këto ditë të vështira për qytetet tonë dhe për familjet tona shprehet solidaritet dhe mirëkuptim për gjendjen. Falënderim doktorëve, policeve, ushtareve, shërbyesve civil, administratës dhe gjithë atyre që sot detyrohen të janë në punë.

Thirrje qytetareve!

Rrini në shtëpi sepse ju jeni ushtaret e vijës së parë të frontit që do e fitoni luftën me Virusin Corona

Mos bëni panik, sepse ushtaret e denje dhe luftëtare nuk hynë në luftë me panik por me besim dhe shpresë për fitore

Beni kujdes, sepse Kujdesi është arma dhe me e vlefshme në këto ditë të vështira

Andaj, se shpejti, se bashku dhe në bashkëpunim më secilin ne do ta fitojmë këtë luftë. Prandaj faleminderit të gjithëve dhe kërkoj që sa me shumë ti ndihmojmë qytetarit në këto ditë të vështira.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj- Faleminderit Petrit

Fjalën e kalojmë Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci- faleminderit shumë Petrit ligji na lejon vetëm 5% të investimeve kapitale që na i kemi 4 milion e 600 mijë euro investime kapitale po ashtu ne i kemi dikun 146 mijë euro nga të hyrat vetanake që janë të gatshme me u përdor sa i perket ndihmave që kanë ardh nga ministria e shëndetësisë nuk e ndava edhe 600 cope oksigjena terapi që kanë ardh AUTO-MED edhe nga ATCM-market 2000 palë doreza dhe kërkoj falje se e kam shtinë si donacion nga ministria e shëndetësisë e në fakt janë donacione që kanë ardh nga kompani

Fjalën e merr Sokol Bylykbashi-Falënderon të gjithë të pranishmit si dhe shpreh një falënderim të veçantë për punën e kryetarit dhe shtabit emergjent rreth menaxhimit të pandemisë ,po ashtu shpreh mirënjohje për punën e pa lodhshme të doktorëve dhe stafit teknik,për punën e policisë dhe zjarrfikësve që janë duke e bërë një punë heroike si dhe për qytetarët që kanë treguar një nivel të lartë të kulturës duke ju përmbajtur udhëzimeve nga niveli qendror dhe të nivelit lokal dhe me mbajtur higjienën në nivel .Sigurisht që e mbështetëm këtë propozim dhe është mirë që kur të përfundon kjo fazë të kemi një raport të veçantë do të ishte mirë që këto mjete me shku të familjet që janë të rrezikuara në aspektin social sepse këto familje kanë nevojë për gjëra bazike duke marr parasysh që ndihma që ja ka dhënë qeveria deri me tani është shumë e vogël.

Fjalën e merr Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-falënderon Sokolin për fjalët e mira dhe mbështetjen që qysh nga dje i kam fillu procedurat për një pako për 600 familje po besoi që kemi me mbërrir sepse 80.000€ i kemi nda i kemi pas mjete në kuadër të drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqënjes sociale i kemi dërgua kërkesat dhe presim të n kthehen dhe çdo familje ti ja bëjmë nga një pako nga 50 euro, unë po propozoi që ne shtab emergjent të jenë dy asamblistë nga opozita dhe një nga pozita dhe bashkërisht ti marrim të gjitha vendimet për çdo cent që ju do ta miratoni sot ashtu si ka nevojë qytetari jonë në këtë situatë emergjente

Fjalën e ka Beqir Kiçina-përshëndet të gjithë të pranishmit dhe përgëzon Komunën kryetarin që ka ndërruar hapat e duhur në përputhje me kohën sepse është situata emergjente koha nuk pret por mendoi që është mirë që është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme në të cilën po ndahen mjete për ti dal ne ballë kësaj pandemie unë kisha propozua që krahas shtabit emergjent të ngritët edhe një fond tjetër që te ju kërkohet mjete edhe donatoreve te ndryshëm që të përkrahin komunën tonë dhe në qoftëse komuna jonë preket të jetë immune nga kjo pandemi të ngritët ai fond dhe të shërbej për nevojat e qytetareve dhe kërkesës se kryetarit për bashkëpunim do ti përgjigjem sepse vetëm kështu të bashkuar do të kalojmë këtë situatë .

Fjalën e merr Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci –falënderon parafolësin për fjalët e mira dhe sqaron sa i përket kërkesës për një shtab tjetër emergjente ne e kemi dërgua një shkresë në nivel qendror dhe i kemi kërkuar nivelit qendror që gjithë ata që janë të gatshme me jep donacione të orientohen në kuadër të nivelit qendror sepse ne po e prishim këtë sistem sepse unë kam shumë probleme me qytetaret e mi ,ne sot jemi duke i nda qytetareve tan 200 pako që ETC i ka nda nga një thes miell nga dy pako lagje dhe dy qumësht dhe ne koordinim me koordinatore të fshatrave ne do ti ndajmë për çdo njërin që është në listë i kemi ndarë fshatrat

Dhe familjet që marrin një herë nuk do të mund të marrin dy here dhe të gjithë do ti kemi nën kontroll.

Fjalën e merr Adem Bucolli-falënderon kryetarin punëtorët shëndetësor, zjarrfikëset, shtabin emergjent për punën që janë duke e bërë,unë kisha pasur dy kërkesa e para për me i kontaktua ndonjë rrobaqepës për me qepë maska te thjeshta dhe e dyta me kontaktua sa me shpesh me administratore të fshatrave që çdo ndihme me pako ose të mos keq përdoret o të shkojë të ai qytetar që me te vërtet ka nevojë faleminderit shumë dhe uroi që të kalojmë sa me lehtë këtë epidemi me sa me pak të prekur

Fjalën e merr Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- një zonjë me ka thirr dhe ka kërkuar që veç me pas material unë qepi dhe i bëj maskat po që ne nuk kemi pas as buxhet as mundësi sepse vullnetar ka po ashtu i kam mbetë borgj me i falënderu edhe punëtorëve e kompanisë pastrimi sepse edhe ata mund të përballen me kontakt të këtij virusi ,punëtorët e ujësjellësit,keku, barnatoreve, marketëve etj

Fjalën e ka Vehbi Berisha-falënderon kryetarin dhe të gjitha dikasteret e komunës siç janë shëndetësia policia zjarrfikësit shtabin emergjent dhe të gjithë ata vullnetar që i janë bashkangjitur thirrjes së kryetarit për bashkëpunim që ta kalojmë sa me mirë dhe me lehtë këtë pandemi kam një kërkesë për me bërë një linjë telefonike që një zyrtar komunal me qenë në kontakt të vazhdueshëm me nevojat e qytetareve siç janë banoret e vet izolim dhe ata të asistencës sociale që të jemi sa me afër tyre në këto ditë të vështira

Fjalën e merr Sabrie Kukaj-falënderon kryetarin dhe të gjithë komunën për menaxhimin e mirë të kësaj situatë desha me pyet rreth deklaramit të pasurisë zoti kryetra është mirë me u sqarua faleminderit shumë.

Fjalën e merr Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci –sa i përket shtabit emergjent kisha kërkuar edhe një herë qe dy anëtare të jen nga opozita dhe një nga pozita me qëllim që qdo gjë të jet sa me transparente.

Fjalën e merr Gani Podrimqaku në emër të grupit Parlamentar të PDK-së dhe për shtab emergjent propozon Qendrim Mulaj

Fjalën e merr Beqir Kiçina nga opozita për shtab emergjent do të jen Petrit Gashi dhe Sokol Bylykbashi.

Fjalën e merr Petrit Gashi nga opozita propozojmë Florentina Elezi, Beqir Kiçina, Gentrit Gerguri

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj; hedh në Votim Propozim vendimi


Ky propozim Vendim u përkrah në mënyrë unanime nga 30 anëtare pjesmarrës..

Kryesuesi i Kuvendit Komunal pasi përfunduan diskutimet konsideroi të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11: 05 min.

Drenas 25.03.2020

Procesmbajtëse:



Zahrie Podrimqaku Subashi



Kryesuesi i Kuvendit

Labinot Halilaj